

TIRANE 2023

RAPORT TEKNIK

OBJEKTI

**URA LIDHËSE PËR FSHATRAT VERMOSH -
VELAN - VELIPOJË**

LENI-ING shpk

Raport Teknik

1. Hyrje

Grupi i projektimit per objektin : “ **Ura Lidhëse për Fshatrat Vermosh - Velan - Velipojë** ”, Njesia Administrative Kelmend ne Bashkine Malesia e Madhe, ka ndjekur hapat e nevojshem te studimit e investigimit per te proceduar ne fazen e projekt zbatimit, analizimit dhe zgjidhjes paraprake te kesaj vepre. Ne kete faze, eshte paraqitur varianti i ures si ure me 6 hapsira drite, perbri ures pasarel te ndodhur ne kete pjese te rrjedhjes se lumit. Bashkëlidhur raportit jane vizatimet e projekt zbatimit dhe preventivi. Zgjidhja e ketij varianti i referohet kushteve topografike, kerkeses se autoritetit kontraktor dhe kushteve te trafikut ne kete aks te cilat jane te moderuara.

2. Qellimi

Qellimi i ketij projekti eshte hartimi i dokumentacionit te nevojshem (vizatime, volume, llogaritje, specifikime teknike, shpronsime) per zbatimin e objektit brenda parametrave teknik te kerkuara nga standartet per ura te ngjashme. Prioritet ne hartimin e ketij projekti ka edhe faktori ekonomik dhe fizibiliteti mbi te cilet u bazua perzgjedhja e variantit final dhe hartimi i projekt zbatimit.

3. Pershkrimi

3.1. Ura

Objekti ndodhet ne Vermosh,Nj.A Kelmend, Bashkine Malesia e Madhe, 84 km larg qendres se Koplikut dhe lidh dy anet e zonave qe ndan rrjedhja e ketij lumi. Aksi i ures ne projekt eshte perbri ures pasarel qe eshte aktualisht funksionale per lidhjen e dy zonave, dhe perpendikular me rrjedhjen e lumit.Prurjet e pakta ne sezonin e veres e benin te mundur kalimin pa veshtirsi te mjeteve ne te. Gjeresia e shtratit eshte e konsiderueshme, keshtu qe hapësira e drites e ures prej afro 19m secila i referohet shtratit te lumit i cili sjell prurjet ne forme rrekesh, perrenjsh ne gjurme te ndryshme.





Ura do te kete lartesine e lire nga shtrati i lumit (nga kuota e sistemuar) 3m e cila parashikohet te thellohet deri ne 3m per faktor sigurie. Kjo lartesi i referohet dhe analizes hidrologjike te basenit. Lartesia ndertimore e ures varet kryesisht nga kushtet teknike te zbatimit te sektorit te xhenios, ushtrise.

3.1.1 Ura beton arme

Referuar prerjes terhore tipike te nje ure, ura beton arme do ndertohet me harqe ne procesin e ndertimit me faza. Pas ndertimit te bazamenteve te pilave dhe ballnave, ndertohet pjesa e poshteme e quajtur 'solete hark', ne fazen tjeter ndertohen muret b/a anesore hapsirave te te cilave mbushet me zhavorr pas kalimit te diteve te nevojshme per marrjen e markes se soletes hark. Pjesa e zhavorrit mund te lihet bosh nqs nga sipermarresi merret persiper te lihet bosh duke lene armaturen e soletes se drejte te "vdekur" brenda, Pas kesaj vazhdohet me ndertimin e soletes se drejte dhe shtreses asfaltike. Gjeresia kaluese do te jete e dedikuar per nje kalim, dhe me mundsi shkembimi ne hyrj-dalje te ures ne karrexhaten e rruges qe eshte parashikuar si pjese e kesaj vepre.





Fig.1 Pamja ballore e piles se ures betonit






Fig.1-1 Pamja ballore e ballit te ures betonit




Fig.2 Planimetria dhe profile gjatesor i ures

3.1.2 Dimensionimi i ballit se ures

Mbeshtetja e ures eshte permasuar duke marre ne konsiderate :

-Thellesine maksimale te gerryerjes se shtratit te lumit te rekomanduar nga hidrogeologu e cila nuk eshte me e madhe se 3.5 metra.

-Thellesine e tabanit te dhene dhe rekomanduar nga studimi gjeologjik, sipas te cilit pllaka e themelit te mbeshtjes duhet te vendoset 4 metra me poshte se niveli I shtratit ekzistues.

-Niveli maksimal I ujit ne shtratin e lumit, i cili sipas llogaritjes nga studimi hidrogeologjik nuk del me shume se 1.2 metra. Kota e projektit te ures i referohet pervecse analizes hidrologjike, por edhe faktorve te tjere, sic eshte topografia dhe kushtet e terrenit per rruget hyrëse – dalese te ures.

Lartesia nga shtrati i lumit deri tek fundi I traut(kapriates) eshte parashikuar 3 metra. Nga kushti teknik rekomandohet qe lartesia rezerve te jete 1 meter. Lartesia shtese prej 0.8 metra eshte lene per tu realizuar nepermjet thellimit te shtratit te lumit. Dimensionim i mbeshtetjeve te ures u eshte nenshtuar edhe arsytetimeve qe lidhen me kategorine e rruges ku do te ndertohet ura.

Pllaka e themelit eshte konceptuar ne formen e gernes U, qe te punoje si pllake beton arme elastike me lartesi $H_p=130$ cm, e mbeshtetur ne nje shtrese betoni te varfer. Ashtu si paraqitet ne figure ne dy anet e kesaj pllake mbeshteten shpatullat e ures, ndersa ne bazen e saj mbeshtetet balli i ures. Permasat e jashtme te pllakes jane 700cm x 610 cm. Per te kursyer betonin dhe armaturen , nga ana e mbushjes pllaka nuk realizohet me beton dhe kjo eshte pjesa qe kursethet ne formen e gernes "U" e vogel. Permasat maksimale te pjeses qe hiqet pllakes jane 280 cm 260 cm. Keshtu siperfaqja neto e pllakes per transmetimin e ngarkesave ne taban eshte afro 35 m².

Balli I ures lidhet ne te dy krahet me shpatullat. Shpatullat e ures mbeshteten tek pllaka e themelit dhe formojne seksionin ne forme "U" duke lidhur me pjesen e ballit te ures. Trashesia e shpatullave ne vendin e takimit me pllaken jane 70 cm dhe lart ne nivelin e trupit te rruges jane 40 cm.




Fig.3 Dimensionimi i Ballit te Ures

3.1.3 Dimensionimi i piles se ures

Pllaka e piles ka permasat 8.5m x 4m. Kuota e tabanit te saj do jete e njejte per te gjitha pilat dhe ballnat. Trupi i saj vjen si paraleloiped me ndryshim seksioni nga pllaka ne mbeshtetjen e jastekut te piles. Ky ndryshim seksioni vjen per te ulur qendren e rendeses se piles dhe rezistuar forcave dinamike te rrjedhjes dhe siguruar mos permbysjen. Jasteku ka permasa 5m x 1.5m mbi te cilin do të montohen mbeshtetjet e mesit te ures tip.




Fig.4 Dimensionimi Piles se Ures

3.2. Rruga

Rruga ekzistuese e aksit ne te cilen ndodhet ura eshte ne gjendje jo te mire per kalimin e mjeteve. Nje pjese e konsiderueshme e saj eshte e pashtuar dhe kalon neper shtratin e lumit. Kjo gjendje e rruges na detyron te mos parashikojm ne projekt zbatim dhe preventive masa perrirësuese te saj, pervec lidhjes se trupit te rruges i formuar me volume e zhavorrit ne ballnat e ures. Ura ka gjeresi kaluese 4m, per nje makine dhe nuk mundeson shkembimin ne ure te mjeteve. Shkembimi do te behet ne hyrje-daljet e saj, duke krijuar trup rruge te mjaftueshem per shkembimin e tyre. Ne projekt eshte parashikuar zgjerim i rrugeve hyrëse deri ne 8m per te mundesuar shkembimin ne keto segmente. Ne profilin gjatesor eshte parashikuar dhe rakordimet perkatese te vijes kaluese.

4. Topografia

Nga rilevimi që është kryer në funksion të hartimit të projekt-zbatimit, kuuota në hyrja të urës, kuota e

vijës kalues është 1093.70 metra mbi nivelin e detit. Ne keto kushte gjeografike, prurjet hidrologjike priten te medha per shkak te reshjeve te bores. Konkretisht keto prurje i ka vlerësuar specialisti hidrogeolog në kaptullin përkatës.






Fig.5 Topografia e Ures

Monografia e pikave

Fillimisht paraqitet lista e pikave të koordinatave të bazamentit gjeodezik në sistemin koordinativ UTM34N, pastaj në mënyrë të detajuar paraqiten monografitë e pikave të bazamentit gjeodezik ilustruar me foto:

Numri i pikës	Nord	East	H	Pershkrim
10	4716507.544	391856.751	1091.829	BM1
11	4716515.435	391878.810	1090.977	BM2
12	4716528.958	391885.337	1092.737	BM3
13	4716517.055	391827.501	1092.295	BM4
14	4716667.064	391938.779	1092.331	BM5
15	4716662.612	391934.791	1092.272	BM6


16	4716673.929	391908.828	1095.692	BM7
----	-------------	------------	----------	-----



N = 4716507.544 m	Gozhdë betoni e ngulur ne murin rrethues përballë rrugës
E = 391856.750m	
H = 1091.829 m	




SKICA





Stacioni: BM-02	
N = 4716515.435 m	Shufër hekur e vendosur ne kulmin e strukturës se betonit mbajtës te urës provizore, ne pjesën hyrëse të urës.
E = 391878.810 m	
H = 1090.977 m	

FOTO	FOTO
	




Stacioni: BM-03	
N = 4716528.958 m	

E = 391885.337 m	Gozhdë betoni e ngulur ne beton, ne pjesën e hyrjes se urës.
H = 1092.737 m	

FOTO	FOTO
	



SKICA




Stacioni: BM-04

N = 4716517.055m	Gozhdë betoni e ngulur ne murin rrethues përballë rrugës, ne drejtimin e urës provizore.
E = 391827.501 m	
H = 1092.294 m	

--	--

FOTO	FOTO
	

SKICA




Stacioni: BM-05

N = 4716667.064 m


E = 391938.779 m

H = 1092.331 m


Gozhdë betoni e vendosur ne kulmin e strukturës se betonit mbajtës te urës provizore, në krahun e varrezave




SKICA



N = 4716662.612m	Gozhdë betoni e ngulur ne betonin mbajtës të urës, në pjesën dalëse të saj.
E = 391934.791 m	
H = 1092.272 m	



SKICA



Stacioni: BM-07	
N = 4716673.929 m	Gozhdë betoni e ngulur ne murin rrethues të varrezave, afërsisht në drejtimin e urës së re të projektuar.
E = 391908.827 m	
H = 1095.692 m	

5. Hidrologjia

Duke pare se pellgu shimbledhes ne aksin ku do te ndertohet ura eshte 5 809 ha bejme llogaritjet hidrologjike duke perpunuar reshjet maksimale 24 oreshe per Stacionin Pluviometrik me te afert ate te Vermoshit.




Fig.6 Pellgu ujembledhes

Perpunimi reshjeve maksimale 24 oreshe Stacioni Pluviometrik Vermosh

NR	VITI	RESHJE 24 h MAX.	VITI	RESHJET DITORE RENDITUR	P % P=m/n+1*100 %	K= H1d/Hmes	K-1		(K-1) ²	P %	Kp	Hp
							+	-				
1	1973	101.4	1986	197.3	8.33		0.797		0.6333	1	5.82	638.8
2	1974	121.4	1974	121.4	16.67	1.106	0.106		0.0112	2	4.58	501.0
3	1975	82.3	1977	119.4	25.00	1.088	0.088		0.0077	3	3.84	421.5
4	1976	111	1979	118.4	33.33	1.079	0.079		0.0062	5	3.07	336.9
5	1977	119.4	1976	111.0	41.67	1.011	0.011		0.00012	10	2.18	239.3
6	1978	105.2	1978	105.2	50.00	0.958		0.042	0.0018	20	1.43	156.95
7	1979	118.4	1973	101.4	58.33	0.924		0.076	0.0058	25	1.27	133.9
8	1982	77.9	1987	90.8	66.67	0.827		0.173	0.02993	30	1.06	116.35
9	1983	82.3	1983	82.3	75.00	0.75		0.250	0.0625	40	0.81	88.9
10	1986	197.3	1975	82.3	83.33	0.75		0.250	0.0625	50	0.63	69.15
11	1987	90.8	1982	77.9	91.67	0.71		0.29	0.0841	60	0.49	53.78
										70	0.38	41.7
										75	0.32	35.12
										80	0.27	29.63
										90	0.18	19.75
										95	0.12	13.17
										97	0.10	10.98
		1207.4		1207.4			1.081	1.081	0.90515	99	0.03	3.29

$H_{mes} = \sum H_{24h} / n = 1207.4 / 11 = 109.76$

$C_v = \frac{\sum (k-1)^2}{n-1} = \frac{0.90515}{10} = 0.30$ kof. i variacionit

Koficijenti i asimetrise per reshjet max. 24 h eshte:
 $C_s = 4 * C_v = 4 * 0.30 = 1.2$

$H_p = K_p * H_{mes} = K_p * 109.76$

Perpunimi i rreshjeve maksimale 24 oreshe sipas te dhenave te Stacionit Pluviometrik Vermosh duke i larguar nga mesatarja e ordinatave te kurbes se sigurise Pirsonit per $X_{mes}=1, C_v=1$ per vlerat e llogaritura te koeficientit te asimetrise C_s

p %	1	2	3	5	10	20	30	40	50
Φ	3.15	2.61	2.31	1.91	1.3	0.73	0.35	0.05	-0.19
$\Phi * C_v$	0.945	0.783	0.693	0.573	0.39	0.219	0.105	0.015	-0.057
$\Phi * C_v + 1$	1.945	1.783	1.693	1.573	1.39	1.219	1.105	1.015	0.943
$h_{mes} * C_v + 1$	213.48	195.7	185.82	172.65	152.56	133.8	121.28	111.4	103.5

p %	60	75	80	90	95	97	99	99.9
Φ	-0.42	-0.74	-0.84	-1.08	-1.24	-1.33	-1.45	-1.58
$\Phi * C_v$	-0.126	-0.222	-0.252	-0.324	-0.372	-0.399	-0.435	-0.474
$\Phi * C_v + 1$	0.874	0.778	0.748	0.676	0.628	0.601	0.565	0.526
$h_{mes} * C_v + 1$	95.93	85.39	82.1	74.2	69.93	65.96	62.0	57.73

Llogaritja e prurjes**Treguesit e Pellgut shimbledhes**

Siperfaqja e pellgut shimbledhes eshte $F = 5\,809$ ha

Gjatesia e perroit mesatarisht 6.5 km

Pjerrësia mesatare e perroit deri ne aks eshte $i = 0.029$

Gjeresia mesatare e shtratit 10 m

Per nga rendesia e vepres, nisur nga normativat e projektimit do te punojme me prurjen llogaritese me 2 % siguri dhe prurjen kontrolluese me 1 % siguri.

5.1- Shpejtesia e rrjedhjes se rrymes se ujit

Sipas formulese se Sokolovskit eshte $V = 17 I^{0.4} b^{0.5}$

Ku I - eshte pjerrësia e shtratit 0.029

b – gjeresia mesatare e shtratit afersisht 10 m.

Nga perllogaritjet rezulton $V = 12.89$ m/sek.

Megenese rrjedhja e ujit neper shpate ne drejtim te perroit kryesor eshte shume me e vogel, atehere shpejtesia zvogelohet me 10 here.

Pra kemi $V_{mes} = V/10 = 12.89/10 = 1.29$ m/sek.

5.2-Llogaritja e kohes se bashkeardhjes

t - koha e bashkeardhjes $= L/3.6 V = 1.4$ ore ,ku L eshte gjatesia e pellgut 6.5 km

5.3-Llogaritja e kohes te ngadalsimit te shiut

$T = \mu \times t$ ku μ - eshte koeficienti i ngadalsimit te shiut dhe llogaritet me formulen
 $\mu = (t+1)^{-0.20} = 0.83$

Duke zevendesuar llogarisim $T = 1.16$ ore.

5.4- Kohezgjatja e shiut

Sipas Venturit jepet me formulen $r = 0.1272 \sqrt{F/i} = 0.1272 \times \sqrt{58.09/0.029} = 5.69$ ore.

5.5- Llogaritja e koeficientit te rrjedhjes

Sipas Korbejt llogaritet me formulen empirike $\alpha = a + b/\sqrt{r}$

Ku a dhe b jane koeficiente empirike; $a = 0.20$ dhe $b = 0.40$; $r = 5.69$

Duke zevendesuar ne formule percaktojme $\alpha = 0.2 + 0.4/\sqrt{5.69} = 0.36$

5.6- Llogaritja e prurjes orare

$Q_{orare} = H^{2\%} / \sqrt{24} = 195.7/4.9 = 39.9$ mm/ore

24 ore

5.7- Llogaritja e reshjeve

Reshjet me 2 % siguri te perpunuara jepen me formulen

$$H_t = Q_{\text{orare}} \times T^{1/3}$$

$$H_t = Q_{\text{orare}} \times T^{1/3} = 39.9 \times 1.16^{1/3} = 41.9 \text{ mm/ore}$$

Prurja llogaritet :

$$0.28 \times \alpha \times H_t \times F$$

Sipas formules se Sokolovskit $Q = \frac{0.28 \times \alpha \times H_t \times F}{t}$

α - eshte koeficienti i rrjedhjes qe per pellgun tone shimbledhes rezultoi 0.36.

F - eshte siperfaqja e pellgut shimbledhes qe per aksin tone eshte 58.09 km².

H_t - sasia orare e reshjeve per 2 % siguri eshte llogaritur 41.9 mm.

t - koha e bashkeardhjes me 2 % siguri 1.4 ore

Duke zevendesuar ne formulen e Sokolovskit marrim prurjen llogaritese $Q = 175 \text{ m}^3/\text{sek}$

Duke marre ne konsiderate treguesit e mesiperm na duhet nje hapsire drite prej 136 m² per te percjelle prurjen me 2 % siguri. Nuk eshte perfshire rezerva qe duhet ti lihet vepres se artit ne lartesi

6. GJEOLGJIA

R A P O R T

MBI KUSHTET GJEOLGJO - INXHINIERIKE TE OBJEKTIT: " Ura Lidhëse për Fshatrat Vermosh - Velan – Velipojë ", BASHKIA MALESI E MADHE

Ky studim perbehet nga keto kapituj :

1. HYRJE
2. VENDODHJA
3. GJEOMORFOLOGJIA DHE RELIEVI

4. NDERTIMI GJEOLGJIK I RAJONIT
5. KUSHTET HIDROGJEOLGJIKE
6. FENOMENET GJEODINAMIKE
7. KUSHTET GJEOLGO – INXHINIERIKE
8. PERFUNDIME DHE REKOMANDIME
9. MATERIALI GRAFIK
10. LITERATURA

1.-HYRJE

Sipas kerkeses se bere nga "LENI-ING" SHPK, gjate muajt Prill 2019, u krye studimi mbi kushtet gjeologo – inxhinierike te sheshit te ndertimit te Objektit: " Ura Lidhëse për Fshatrat Vermosh - Velan – Velipojë", Bashkia Malesi e Madhe

Pasi u be nje rikonicion i hollesishem ne terren nga autori i studimit dhe pala porosites, duke pare faktoret gjeologjike, gjeomorfologjike, hidrogjeologjike e gjeologo-inxhinierike ne shesh, si dhe formen lineare te objektit ne studim, u ra dakort qe studimi te behet me rikonicion te hollesishem gjate gjithë aksit te lumit dhe vendit te ndertimit te ures.

Njekohesisht u be dhe rilevimi gjeologjik i zones per te evidentuar hollesisht ndertimin e gjeologjik, llojet shkembore, gjendjen e tyre gjeoteknike, merdhenjet mes tyre, tektoniken, ujembajtjen dhe fenomenet gjeodinamike ne shesh dhe zhveshjet natyrale.

Gjate procesit te rilevimit u moren kampione ne strukturat e prishur e te paprishur per çdo shtrese.

Te gjitha pershkrimet gjeologjik, gjeoteknike, fenomenet gjeodinamike, hidrogjeologjike etj qe u vrojtuan ne terren u hodhen ne planin topografik ne shkalle 1 : 2000 qe na u vu ne dispozicion nga pala porosites dhe ne prerjen gjeologjike. Kuotat e punimeve jane dhene sipas kesaj harte.

Ballnat dhe pilat e ures do te ndertohen te reja mbi te cilat do te vendoset ura e re bailey.

Ne perpilimin e ketij studimi gjeologo-inxhinierike jemi mbeshtetur edhe ne studimet e tjera te bera ne kete zone nga autori te ndryshem, ne literaturen gjeologjike, hidrogjeologjike, gjeologo-inxhinierike etj.

2.-VENDODHJA E SHESHIT

Sheshi i ndertimit te objektit ndodhet ne zonen e fshatit Vermoshi te Bashkise Malesi e Madhe te Qarkut Shkoder, ne mesin e ketij fshati. Ura qe projektohet lidh dy lagjet e ketij fshati. Gjeresia e lumit (zallishtes) ne kete segment eshte rreth 120 metra, por kjo gjeresi rritet duke kaluar pjeset e argjinaturave ne te dy anet e ketij lumi. Argjinaturat kane disiplinuar rrjedhjen e lumit, erozionin ansor (linear), mbrojtien e tokave bujqesore dhe te shtepive te banimit te fshatit Vermosh.

3.-GJEOMORFOLOGJIA DHE RELIEVI

Fshati Vermosh perbene pjesen me veriore te Shqiperise dhe kufizohet ne perendim, veri dhe lindje me vijen kufitare me Malin e Zi, ndersa ne jug kufizohet me fshatrat Lepushe, Selce, Vukel etj. te Malesise Madhe te Qarkut Shkoder. Nga rajonizimi fiziko-gjeografik rajoni i Vermoshit i

perket krahines se Alpeve Shqiptare, zones se Alpeve Prendimore, me relief bjeshkore, te prekura nga levizjet neotektonike te cilat i kane dhene pamjen e sotme morfologjike, me vargmale te lugines se Cemit, Selces dhe te Vermoshit, me coptime vertikale deri ne 400 m/km² dhe coptim horizontale 0,3 km/km². Relievi i rajonit te Vermoshit si ne veri, jug, lindje e perendim eshte kodrinore e malore me kota deri 2100 m rralle me shume. Zona e fshatit Vermosh ka kuota 1090 deri 1250m, afersisht 4.0 km ne veri te ketij fshati ndodhet maja e Marlules me lartesi 2186 m, ndersa ne jug ndodhet maja e Grebenit me lartesi 1840m. Lumi Vermosh me rrjedhje nga perendimi ne drejtim te lindjes formon nje lugine me shtrirje afersisht sipas lumit perendim-lindje ne mes te ketyre maleve te larta e te pyllezuara duke i dhene nje pamje turistike fshatit Vermosh dhe kesaj zone ne tersi. Relievi behet bjeshkore, kodrinore-malore dhe i thyer per shkak te ndertimit gjeologo-strukturor te gelqeroreve, gelqeroreve dolomitik e ranorik dhe flishit te cilet kane formuar monoklinale, sinklinale dhe antiklinale (te rrudhosur) te cilet duken shume qarte ne malet e zhveshura dhe ne luginen e lumit te Cemit ne fshatrat Lepushe, Selce, Vukel etj.

Keto struktura pervec rendesise gjeologjike e gjeoteknike kane rendesi e bukuri te vecante turistike, çdo vit po behen me te vizitueshme. Ne formimin e pejsazhit te sotem te zones kane ndikuar proceset e ndryshme gjeologjike si tektonikat dhe neotektonikat, erozioni, perajrimi, karstezimi, veprimtaria e ujrave siperfaqesore, akumulimi, ndryshimi i kushteve termodinamike, rreshqitjet, shembjet, ridepozitimi i mases se prishur si dhe veprimtaria e njeriut. Ne kohe te ndryshme here njeri, here tjetri faktor ka predominuar dhe kane sjelle ndryshime jo te njejta. Shpatet ku kryhet studimi paraqiten me relief te diferencuar. Fshati Vermosh ka nje siperfaqe toke bujqesore te kufizuar, meqenese siperfaqja dominuese e saj perbehet nga nje territor malore-

kodrinore dhe nga prenia e shkebinjve gelqerore e flishor qe ndikon negativisht ne zhvillimin bujqesor te kesaj zone. Popullsia merret me blegtori, me kultivim e hardhive dhe me prodhime bujqesore e blegtoarele dhe kohet e fundit me turizem malore i cili po rritet e zhvillohet nga viti ne vit. Pyllezimi ne pjeset periferike te Vermoshit eshte i zhvilluar, i perfaqesuar nga shkurret si shkoza, frasheri, lisi, pisha, ahu, geshtenja etj. te cilet mbrojne kete territore nga erozioni. Bimesia, reshjet dhe ujrat kane ndikuar qe te krijohet nje shtrese toke humusore, ku jane te zhvilluara shume bimet natyrore, mjeksore dhe kullotat. Ka tipe te veçanta bimesh qe takohen vetem ne kete zone. Ne pyjet e kesaj zone takohen kafshe te egra si dhelpra, ujku, lepuri, çakalli, ne pyjet e larta takohet kaprolli, dhija e eger, derri i eger, ariu i murem, rreqepulla, vjedulla etj.

4.-NDERTIMI GJEOLGJIK I RAJONIT

Zona e Vermoshit bene pjese ne Albanidet e Jashtme ne pjesen prendimore te saj. Ne ndertimin gjeologjik te rajonit takohen depozitime me moshe Jurasike, Kretake dhe te Kuaternarit. Pershkrimet e te cilave behen duke filluar nga ato me moshe me te vjeter deri tek ato me moshe me te reja si me poshte :

4/1. Depozitimet Triasikut te mesem (T_2)

4/2. Depozitimet Jurasikut te siperm-Kretakut te poshtem (J_3t-Cr_2cm), Titionian i siperm-Cenomanian.

4/3. Depozitimet e Kretakut te siperm (Cr_2m), Mastriktian

4/4. Depozitimet aluviale te Kuaternarit (Q^a)

4/5. Depozitimet deluviale te Kuaternarit (Q^d)

4/1. Depozitimet Triasikut te mesem (T_2)

Depozitimet Triasikut te mesem kane perhapje ne pjesen veriore te Vermoshit ne krahun e majte te rrjedhjes se lumit. Kane kontakt tektonik dhe mbihypes mbi depozitimet flishore te Jurasikut te siperm-Kretakut te poshtem (J_3t-Cr_2cm). Perbehen nga shkembinj rreshpor, gelqerore te nderthurura ne mes tyre te formuara ne ambjente pellagjike me dalje siperfaqesore mbi 3.0 km. Keto shkembinje shpeshe here jane shtresore, mesatarisht deri kompakt, vende-vende kane natyre ranorike te shkrifte. Ne shkembinjt karbontike ne disa raste takohen mbetje organizmash te fosilizuara mbi te cilet eshte percaktuar edhe mosha e Triasikut te mesem. Shtrirja e tyre eshte kryesishte VP-JL me renje afersisht VL me kend 15 deri 40°. Mbi keto shkembinje takohen gelqeroret organigjen, dolomitet, etj.

4/2. Depozitimet Jurasikut te siperm-Kretakut te poshtem (J_3t-Cr_2cm), Titonian i siperm-Cenomanian

Keto depozitime perfaqesohen nga nderthurja e shtresave gelqerore biomikritik me depozitimet flishoidale ranore, mergelore. Keto jane depozitime pelagjike, shtrihen mbi depozitimet Triasike. Depozitimet Jurasikut te siperm-Kretakut te poshtem (J_3t-Cr_2cm) kane shtrirje VP deri L-P me renjeVL deri V me kend $40-52^\circ$ me dalje siperfaqesore mbi 1.0 km. Keto depozitime kane ngjyre gri jane pjeserisht deri mesatarishte kopakt, te rrudhosur dhe te prekura nga tektonika mbihypse ne dysHEME mbihypin mbi depozitimet Kretakut te siperm (Cr_2m) dhe mbi tavanin e tyre mbihypin depozitimet Triasikut te mesem (T_2).



Foto. Shkembinjë rrenjesor te (J_3t-Cr_2cm) ne krahun e majte te rrjedhjes se lumit Vermosh, 20m ne perendin te themeleve te ures ekzistuese te varur.

Shkembinjë rrenjesor shtresore te (J_3t-Cr_2cm) ne krahun e majte te rrjedhjes se lumit Vermosh, 20m ne perendin te themeleve te ures ekzistuese te varur kane kontakt me depozitimet aluviale zallishtore te lumit dhe ne pjesen e siperme kontaktojne me depozitimet suargjilore te varrezave te fshatit Vermosh. Kjo dalje siperfaqesore perbehet nga shtresa ranoresh, gelqerore ranorik, gelqerore dolomitik me ngjyre gri dhe rreshpe argjilore alevrolitike ngjyre te erret ne grit e nderthurura ne mes tyre. Kjo dalje e shkembinjve rrenjesore eshte deri mesatarisht kompakte per faktin se gjate shtrirjes sipas kontaktit te shtresave dhe kryqe tyre kane çarje, pjeserisht te mbushura me materjale argjilore dhe jane te perajruara.

Shkembinjë rrenjesor shtresore te (J_3t-Cr_2cm) te latre shkruar kane gjatesi 10 deri 15m, me trashesi te dukshme 0.6m deri 2m, shtresat e ranoreve, gelqeroreve ranorik, gelqeroreve dolomitike kane trashesi deri 60 cm, ndersa ato rreshpore argjilore e alevrolitike kane trashesi me te vogla 5 deri 20cm. Elementet e renjes te kesaj shteresa jane: Azimuti I shtrirjes 110° , Azimuti I renjes 20° dhe kendi i renjes 49° .

Shkembijnjt rrenjesor gelqeroro-ranorike shtresore vazhdojne ne thellesi poshte depozitimeve aluviale e zallishtore te shtratit te lumit te Vermoshit.

4/3. Depozitimet e Kretakut te siperm (Cr_{2m}), Mastriktian

Kretaku i siperm (Cr_{2m}) i zones se Vermoshit perfaqesohet nga nderthurje flishoidale argjilo-ranorik i nenzones se Valbones me gelqeroret dhe ne pjeset periferike rrethohet nga depozitimet karbonatike te Jurasikut dhe te Triasit. Keto depozitime ne pjesen veriore sipas rrjedhjes se lumit te Vermoshit kontaktojne tektonikisht me mbihypjen e depozitimeve gelqerore biomikritik dhe flishoidale ranore, mergelore te Jurasikut te siperm-Kretakut te poshtem (J_3t-Cr_{2cm}). Flishi i Kretakut te siperm (Cr_{2m}) eshte i perhapur ne krahun e djathte te rrjedhjes se lumit Vermosh me dalje siperfaqesore mbi 3.5 km. Shtrirja e flishit ndryshon nga VP deri ne VL me renje nga VL deri ne VP me kend nga 20^0 deri 40^0 .

4/4. Depozitimet aluviale te Kuaternarit (Q^3)

Keto depozitime shtrihen sipas lumit te Vermoshit dhe perbejne shtratin dhe pjeset ansore te tij.

Objekti i studimit ku do te ndertohet ura mbi kete lume i perket pjese se meseme te rrjedhjes se ketij lumi. Ne zonen ku do te ndertohet ura lumi ka pjerresi te vogel deri 3 grade rralle me shume dhe materjali i ngurte aluvialo-zallishtor ne kete zone eshte mesatarisht deri i perpunuar nga transporti dhe depozitimi i lumit.



Foto. Pamje te materjalit te ngurte poplor e copezor ne shtratin e lumit Vermosh, prane ndertimit te ures, te perbere nga shkembinj ranorik e me rralle nga gelqeror e gelqeror ranorik.

Depozitime aluviale te lumit Vermosh perbehen nga zallishte me shtrirje sipas lumit nga lindia deri lidore-juglidore, me azimut shtrirje mestar 105° dhe perbejne gjithë gjatesin e lumit me gjersi nga 200 deri 250m me thellesi mbi 15m. Depozitimet zallishtore perbehen kryesisht nga copa, zhavore dhe me pak nga rera, popla e llumra te cilat ne pershkrimin litologjik te tyre eshte veshtite qe te ndahen per shkak te perzierjes heterogjene te tyre. Depozitimet zallishtore sipas shtratit te lumit jane te shkriфта, ndersa ne pjeset ansore ne te dy anenve e shtratit ne drejtim te lagjeve te banuara mbi te cilat vendosen suargjilat behen pak me te ngjeshur. Materjali i ngurte aluvial, zallishtor nga ana litologjike dhe petrografike perbehet kryesisht nga shkembinje ranorik, ranoriko- gelqerore e me pak nga gelqerore, me forme petezore dhe eliptike, gjendje e lageshtise se ketyre depozitimeve eshte mesatarisht e ngopur me uje me nivel te ujrave nentoksore deri 1.5m. Materiali mbushes perfaqesohet nga rera e surera. Depozitime aluviale te lumit Vermosh kontaktone tangresivisht mbi depozitimet flishore te bazamentit.

4/5. Depozitimet deluviale (suargjila) te Kuaternarit (Q^d)

Jane depozitime te perhapura ne luginen e Vermoshit, ne pjeset e poshtme te shpateve ne te dy anet e lugines, jane te lidhure me format morfologjike te relievit te sotem. Jane formuar ne kushte te ndryshme fiziko-gjeografike e gjeologjike me ndryshime ne kohe dhe hapesire. Nga ana gjenetike i perkasin depozitimeve deluviale te cilat ne emertesat gjeologo-inxhinierike quhen edhe suargjila. Ne zonen e Vermoshit suargjilat mbivendosen mbi depozitimet aluviale zallishtore te lumit Vermosh ne te dy anet e tij me gjersi deri 200m dhe luajne rolin e shtreses te pa pershkushme

per ujrat qe kane depozitimet aluviale. Suargjilat kane trashesi deri ne 6m prane shpateve, rralle me shume. Pjesa prane siperfaesore e tyre deri ne thellesin 07-1.0m perbehet nga dhera vegjetale ngjyre kafe te errte humusore me lende organike e rrenje bimesh te cilat nuk duhet te perdoret per bazamente ndertimi. Tokat vegjetale perdoren per toka bujqesore nga banoret e fshatit Vermosh. Shtresa e suargjilave qe ndodhet me ne thellsi nga 1 deri ne 6m e ne disa raste me shume perbehet nga suargjila ngjyre kafe me copa te rralla e te vecuara guralecesh deri 7cm me perberje ranorike, ranoriko- gelqerore e me rralle nga gelqerore. Keto suargjila jane deri mesatarisht kompakt dhe perdoren per themele te objekteve te cekte deri te mesme. Ne keto suargjila banoret e fshatit Vermosh kane ndertuar shtepit e banimit.

5. KUSHTET HIDROGJEOLOGJIKE

Zona e Vermoshit ku ndodhet fshati me te njejtin emer eshte i pasur me ujra siperfaqesore si, lumi i Vermoshit i Cemit dhe shume perroi e perrocka me ujra sezonale ne kohe dimri e shirash, gjithashtu takohen burime ujore dhe karstike te lidhura kryesishte me shkembinjte ranore, gelqerore e karbonatike. Lumi i Vermoshit kalon permes fshatit Vermosh me gjatesi afersisht 22 km brenda territorit Shqiptar, me rrjedhje nga perendimi ne drejtim te lindjes, ndersa ne pjesen prendimore e jugprendimore te fshatit Vermosh ku lumi perbene pjesen e siperme te rrjedhjes se tij ka drejtim rrjedhje nga jugperendimi ne drejtim te verilindjes me gjatesi afersisht 6 km ku lumi peson divijim rrjedheje nga perendimi ne drejtim te lindjes duke kaluar ne mes te fshatit Vermosh.



Foto. Pamje e rrjedhjes se lumit Vermosh ne vendin ku do te ndertohet ura ne fshatin Vermosh

Lumi buron nga Alpet Shqiptare ne kuote mbi 1700 m. Ne pjesen e siperme ka rrjedheje te shpejt e te vrullshme duke formuar lugina te thella dhe te ngushta ndersa ne pjesen e mesme te rrjedhjes ne fshatin Vermosh formon lugin te gjere. Lumi i Cemit fillon rrjedhjen afersisht 5 km ne jug te Vermoshit nga zonat e Selces dhe vazhdon rrjedhjen ne drejtim te JP ne drejtim te Tamares. Ky lum buron nga Alpet Shqiptare e derdhet ne Moraçe me rrjedhje nga verilindja ne drejtim te jugperendit. Ne pjesen e siperme ka rrjedheje te shpejt e te vrullshme duke formuar lugina te thella dhe te ngushta ndersa ne pjesen e poshtme ne fushen e Cemit ka rrjedhje te ngadalte. Perronjt e zones Vermoshit kane gjatesi deri 3 km me rrjedhje afersisht perpendikular me aksin e lumit Vermosh dhe derdhen ne kete te fundit. Ne kohe shirash e dimri rrisin prurjet e tyre. Klima eshte mesdhetare - kontinentale. Ne dimer temperature arrin deri -25° dhe ne vere deri ne $+ 32^{\circ}$.

Reshjet ne pergjithesi jane te karakterit mesdhetar, mesatarja vjetore arrijne 2500-3000mm.

Nga analizat e kryera rezulton se jane ujra natyrale, ato nuk jane agresive ndaj hekurit dhe betonit.

6.-FENOMENET GJEODINAMIKE

Ne studimet gjeologo- inxhinierike eshte e rendesishme studimi i fenomeneve gjeodinamike te cilet kane lidhje direkte me bazamentet e objekteve inxhinierike. Per studimin e fenomeneve gjeodinamike te zones ku do te ndertohet ura dhe ne pjeset periferike te saj jemi mbeshtetur ne studimet tone ne terren duke i pare nga afer dhe me saktesi keto fenomene, ne punimet e kryera, ne te dhenat e studimeve te me parshme te kesaj zone dhe ne te dhenat e literatures gjeologjike. Bazuar ne keto te dhena po bejme pershkrimin e fenomeneve gjeodinamike qe jane prezente ne keto formacione gjeologjike. Fenomenet me te dukshme gjeodinamike qe verehen ne kete zone jane:

- 6.1. Shplarjet siperfaqesore
- 6.2.Fenomeni i perajrimit
- 6.3. fenomeni i erozionit lumor
- 6.4. Fenomeni i rreshqitjes
- 6.4. Fenomeni karstik

6.1.- Shplarje siperfaqesore, ne fshatin Vermosh dhe ne pjeset periferike te tij takohen, shplarjet siperfaqesore me intensitet me te dobet. Ky fenomen gjeodinamike eshte i zhvilluara ne zonat ku ka me shume eluvione e deluvione ne shpatet malore me pjerrresi mbi 9 grade. Jane aktive ne kohe reshjesh dhe shkaktojne prurje te ngurta me dhera. Me teper verehen ne zonat e shpyllezuara ku ka perzierje te suargjilave me flishin e me gelqeroret . Suargjilat e dherat preken lehte nga shplarjet siperfaqesore ne krahasim me flishin e me gelqeroret duke krijuar nje siperfaqe abrasive e te thepisura te flishit e te gelqeroreve me relief pozitive qe verehen ne te dy anet e fshatit Vermosh. Permasat e shplarjeve siperfaqesore jane: gjatesia nga 50 –140 m, gjeresia 40 –90 m, thellesia e erozionit 0,2 –2 m. Ne keto zona rekomandojme pylllezime, mure mbrojtese gjate perrenjve dhe kanale kullues prane skrapates se rruges.

6.2.-Fenomeni i perajrimit

Fenomeni i perajrimit eshte i dukshem ne te dy anet e lumit Vermosh ne shpatet ansore te ketij lumi dhe ne tokat buqesore te fshatit Vermosh dhe ne formacionet rrenjesore qe perbehen nga depozitimet flishore, ranore, gelqerore, dolomitike me çarje e mikroçarje etj te Triasikut, Jurasikut e Kretakut dhe depozitimet eluviale, deluviale e proluviale te Kuaternarit. Keto shkembinte te prekur nga veprimtaria e agjenteve atmosferike transformohen nga shkembinte te forte, mesatarisht te forte, te bute deri ne suargjila e dhera. Ky fenomen takohet me teper i zhvilluar ne zonat me relief te bute, me pjerrresi te vogel dhe me bimesi. Keto shkembinte te tjetersuar permbajne çarje te perajrimit te cilet kane sherbyer dhe sherbejne per depertimin e ujrave te infiltracionit dhe kane ndikuar ne formimin e depozitime eluviale, deluviale, suargjilave dhe ne dobessimin e tregueseve fiziko – mekanik te ketyre shkembinjve. Thellesia e perajrimit eshte me e madhe ne depozitimet ranore, argjila, eluviale, deluviale qe arrin deri 5 metra se sa ne shkembinjte mesatarishte te forte, e te forte qe kane thellesi me te vogel 1-3 m. Ky fenomen do te

shfaqet me teper pas germimit te skrapatave te punimeve ne zonat me depozitime te buta me lartesi mbi 1m, n.q.s. skarpatat do te lihen te hapura per shume kohe dhe nuk do te behen me mure mbrojtese ose me pjerresi me te vogel se 25° ato do te shemben.

6.3. Fenomeni i erozionit lumor

Erozioni i lumit Vermosh eshte i zhvilluar ne shkembijnjt flishore, flishoro-karbontik pjeserisht te qendrueshem te prekura nga perajrimi, çarshmeri, tektonika e zhvilluar si dhe faktoret hidrologjik. Veprimtaria erozionale e lumit te Vermoshit gjate Neogjen-Kuaternarit ka qene dhe vazhdon te jete aktive duke krijuar nje lugine ne formen e U-se si ne fshatin Vermosh dhe ne disa raste ne lindje dhe ne perendim te ketij fshati ka formen e V-se. Ne pjeset e siperme te rrjedhjes se ketij lumi erozioni eshte i zhvilluar ne dy drejtime anesore dhe fundor per shkak te disnivelit vertikal qe krijon lumi.



Foto. Erozion anesor i lumit Vermosh ne anen e djathte te rrjedhjes

Ne pjeset e mesme te rrjedhjes se lumit ne fshatin Vermosh erozioni anesor (linear) behet me i zhvilluar dhe me pak arozioni fundor. Ne fshatin Vermosh erozioni anesor I lumit ka krijuar nje gjersi deri 300 m te shtratit. Lumi ne kete fshat ka nje pjerresi te voge deri 3° rralle me shume qe ndikon ne rrjedhjen e lire te lumit ne siperfaqen e ketij shtrati. Kryesisht ne dimer kur prurjet dhe energjia e lumit rritet edhe drejtimi i rrjedhjes se lumit ndryshon nga njera ane e bregut ne anen tjetet duke krijuar erozione anesore te shkembinjve. Erozioni anesor I ketij lumi ka shkaktuar demtime te tokave bujqesore te fshatit Vermosh ne te dy anet e rrjedhjes se tij. Per mbrojtjen e tokave bujqesore te ketij fshati jane ndertuar agjinatura ne te dy anet e rrjedhjes se tij, por argjinatura me te gjata jane ndrtuar ne anen e djathte te rrjedhjes se

lumi kryesisht ku është ura e varur ekzistues dhe ku do të ndërtohet ura e re. Argjinatura në anën e djathtë të lumit ka gjatësi mbi 300m dhe lartësi 2.5-3m mbi nivelin ekzistues të lumit, në prerje ka formën e një prizmi me baze mesatarisht të gjera 10m dhe në pjesë të sipërme 2-3m. Argjinatura është ndërtuar me materiale të ngurta, zallshtror të lumit, në të gjithë faqen e anës së lumit të argjinaturës është ndërtuar një mur mbrojtës me tel gabion me trashësi 0.5m e gjësi 3m. Në cilin pjesën e lumit është lidhur me themelet me mur gabion pjesërisht të prishura nga erozioni anësor.



Foto. Mure mbrojtës i argjinaturës me themele me mur gabion në anën e djathtë të rrjedhjes së lumit

Themelet me mur gabion kanë gjatësi 2-3m të dukshme, me trashësi 1-2m, 1m poshtë nivelit të lumit dhe në disa raste 1m sipër nivelit të lumit. Në të dy anët e kembës së urës së varur janë ndërtuar këto lloje argjinaturash për mbrojtjen nga erozioni anësor. Në afërsi të ballit (kembës) të anës së djathtë të rrjedhjes së lumit, në pjesët e sipërme dhe të poshtme të saj në afërsi 10m-15m janë ndërtuar divjusa të lumit duke vazhduar në distancë afërsisht 20m me sipër dhe me poshtë divjuse të pare janë ndërtuar divjusa të tjera në vazhdimsi me tel gabion të lidhura me murin mbrojtës dhe me themelet që janë të ndërtuar me tel gabion të lartë shkruar. Këto divjuse të demtuar nga erozioni anësor kanë gjatësi të dukshme 1-2.5m, të lartë 2m, 1 metershi i pare është i gjërë 3m dhe ndodhet në nivelin e ujit dhe 1 metershi tjetër është e gjëri 2m dhe vendoset sipër murit gabion 3 m. Kjo argjinaturë me muret mbrojtës dhe divjusat me tel gabion e kanë mbrojtur nga demtimi urën e varur, tokat bujqësore dhe shtëpitë e fshatareve të Vermoshit.

Erozioni anësor i këtij lumi në fshatin Vermosh, në objektet inxhinierike, në tokat bujqësore etj mbrohet vetëm me argjinaturë të lidhura me divjusa të cilat do të jenë të shpeshta sipas energjisë së rrjedhjes së lumit të cilat janë maksimale në kohë reshjesh intensive dhe dimrit me shira dhe stuhi. Erozioni anësor i këtij lumi në fshatin Vermosh dhe me gjërë duhet që të monitorohet nga ana gjeologjiko-inxhinierike e teknike çdo vit me qëllim që të evitohet ose të minimizohet rreziku i këtij fenomeni gjeodinamik.



Foto. Mur mbrojtës i argjinatures dhe mur divius me tel gabion sipër ballit të djathtë të urës së varur.



Foto. Mur diviues e mbrojtës me tel gabion i argjinatures në anën e djathtë të rrjedhjes së lumit

PRANË DY BALLRAVE TË URËS SË RE që do të projektohet 20m në perëndim të urës së varur ekzistuese të merren masa mbrojtëse nga ana e projektuesit.

-Per ballin e urës në anën e djathtë të rrjedhjes së lumit duhet të riparohet skrapata e argjinatura nga ana e lumit pjesërisht e prishur me gjatësi 100m, me gjatësi 50m në pjesën e sipërme dhe me gjatësi 50m në

pjesen e poshtme te ballit te ures duke rregulluar muret mbrojtese me themelet dhe muret divius ne argjinature te gjithe keto me tel gabion me permasat e argjinares ekzistuese:

Ne faqen e anesore te argjinature nga ana e lumit te riparohet muri mbrojtës me tel gabion me trashesi 0.5m e lartesi 3m i cili ne pjesen e lumit te lidhet me themelet me mur gabion.

Te riparohen themelet me mur gabion, te kene gjeresi 3-4m, me lartesi 2m, 1m poshte nivelit te lumit dhe 1m siper nivelit te lumit. Ne distance 15m nga te dy anet e ballit te ures larte e poshte saj te ndertohen diviusa me mur guri me tel gabion dhe ne vazhdimsi 20m mbi diviusat e pare te

ndertohen edhe dy diviusa te tjere larte e poshte diviusave te pare. Keto divjusa te vendosen mbi muret e themeleve me tel gabion dhe te kane gjatesi 3-4m, te larte 2m, 1 metershi i pare te jete i gjere 3m mbi nivelin e ujit dhe 1 metershi tjetër te jete i gjere 2m dhe te vendoset siper murit gabion 3 m te pare.



